

VENDIM
Nr. 673, datë 30.10.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI
NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 1451, FSHATI
DARZEZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU
FIER, NGA SHOQËRIA “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 2, të nenit 21, të vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “*Sunny Side Energy*” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: shoqëria “*Sunny Side Energy*” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: M34504202R;
- c) Tipi i centralit: fotovoltai;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 100 mw;
- d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltai do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier;
- e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave;
- gj) Shoqëria “*Sunny Side Energy*” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltai;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “*Sunny Side Energy*” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë

kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “*Sunny Side Energy*” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1

KOORDINATAT NË KRRGJSH PËR “SUNNY SIDE SOLAR” PARK 100mw					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
P1	447813.222	4512553.767	P25	447815.918	4512152.483
P2	448523.561	4512550.03	P26	447812.46	4512345.641
P3	448523.685	4512353.714	P27	447813.193	4512358.423
P4	448520.344	4512340.963	P28	448610.538	4512748.067
P5	448515.074	4512158.652	P29	449204.12	4512746.632
P6	448332.506	4512146.982	P30	449203.952	4512731.034
P7	448332.775	4511985.564	P31	449188.706	4512549.716
P8	448585.947	4511946.877	P32	448986.698	4512536.871
P9	448583.816	4511757.835	P33	448986.602	4512349.67
P10	448533.259	4511742.572	P34	449059.331	4512337.004
P11	448533.227	4511561.209	P35	449053.765	4512153.302
P12	447813.203	4511564.615	P36	449077.067	4512140.055
P13	447813.34	4511738.073	P37	449077.344	4511953.524
P14	448118.802	4511758.305	P38	449184.872	4511941.902
P15	448121.527	4511947.399	P39	449182.988	4511750.582
P16	447903.826	4511959.048	P40	448656.474	4511753.713
P17	447904.525	4512146.825	P41	448655.961	4511941.477
P18	448146.531	4512161.186	P42	448600.246	4511953.087
P19	448148.865	4512295.395	P43	448601.298	4512141.001
P20	448223.763	4512342.928	P44	448845.752	4512154.444
P21	447983.842	4512344.518	P45	448849.908	4512336.699
P22	447983.849	4512283.232	P46	448613.324	4512349.124
P23	447924.917	4512250.588	P47	448613.485	4512536.138
P24	447921.501	4512171.86	P48	448613.065	4512548.954

